


---

**INVESTITORI**  
**KOMUNA E SUHAREKËS**  
Drejtoria e Shërbimeve publike, Mjedis dhe Emergjencë  
Rr. Brigada 123, Suharekë 23 000



**PROJEKTI I PËRZGJEDHJES**  
**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR NDËRTIMIN E**  
**RRUGËS “GURI I MATOZIT – GRADANCË” NË MUSHTISHT, FAZA I**  
**ME GJATESI L= 2,113.0 m’**

Prill - 2025

---

**Projekt i Përzgjedhjes**  
**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR NDËRTIMIN E**  
**RRUGËS “GURI I MATOZIT – GRADANCË” NË MUSHTISHT, ME**  
**GJATESI L = 2,113.0 m’**

|                              |                                                                        |
|------------------------------|------------------------------------------------------------------------|
| <b>Investitori:</b>          | <b>KOMUNA E SUHAREKËS</b>                                              |
| <b>Personi i Autorizuar:</b> | Enver Shabani<br>Drejtoria e Shërbimeve publike, Mjedis dhe Emergjencë |
| <b>Adresa:</b>               | Rr. Brigada 123, Suharekë 23000                                        |
| <b>Lokacioni:</b>            | Guri i Tanozit - Gradancë                                              |
| <b>Tel:</b>                  | 029 / 271 263, 029 271 282, 038 200 45 017                             |
| <b>Email:</b>                | komuna.suhareke@rks-gov.net                                            |

**Hartuese e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

|                        |                                                                                                                                                                  |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emri:</b>           | Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari                                                                                                                                   |
| <b>Email:</b>          | <a href="mailto:Blerinabajraktari1@gmail.com">Blerinabajraktari1@gmail.com</a><br><a href="mailto:Blerinabajraktari3@gmail.com">Blerinabajraktari3@gmail.com</a> |
| <b>Tel:</b>            | +383 49 588 634                                                                                                                                                  |
| <b>Nr. i Licencës:</b> | 07/20                                                                                                                                                            |

**KOMUNA SUHAREKËS**  
Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve publike,  
Mjedis dhe Emergjencë

**Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari**

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

## PËRMBAJTJA:

|                                                                                                              |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. HYRJE .....                                                                                               | 5  |
| 2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS .....                           | 6  |
| 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TE NDERTIMIT TE RRUGËS “GURI I MATOZIT – GRADANCË” FAZA 1.....                     | 7  |
| 3.1 Përshkrimi i Lokacionit.....                                                                             | 7  |
| 3.1 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit .....                                                          | 8  |
| 3.2 Përshkrimi i Veçorive Kryesore të Fazës Operative .....                                                  | 9  |
| 3.3 Përshkrimi i procesit te punës .....                                                                     | 10 |
| 3.5 Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit..... | 12 |
| 4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E RRUGËS KRYESORE “GURI I MATOZIT – GRADANCË” ..... | 14 |
| 5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT .....                                                                          | 15 |
| 5.1. Hidrografia .....                                                                                       | 15 |
| 5.2. Kushtet klimatike .....                                                                                 | 16 |
| 5.3. Zonat e Mbrojtura .....                                                                                 | 17 |
| 5.4. Flora, fauna dhe persazhi .....                                                                         | 17 |
| 5.5. Ndotja dhe degradimi.....                                                                               | 18 |
| 6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS .....                                                   | 19 |
| 6.3. Ndikimet në ajër.....                                                                                   | 19 |
| 6.2 Ndikimet në tokë.....                                                                                    | 19 |
| 6.3 Ndikimet në ujë.....                                                                                     | 19 |
| 6.4 Ndikimet në peizazh .....                                                                                | 20 |
| 5.5 Ndikimet në Florë dhe faunë.....                                                                         | 20 |
| 6.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë .....                                                               | 20 |
| 6.7 Ndikimet nga zhurma.....                                                                                 | 21 |
| 6.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....                                                         | 21 |
| 7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS .....                                                        | 22 |
| 8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE .....                                            | 23 |
| 9. PERSHKRIMI I MASAVE PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS .....                                             | 24 |

|                                                                                                                                       |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër .....                                                                                    | 24 |
| 9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë .....                                                                                    | 25 |
| 9.3. Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë .....                                                                                    | 25 |
| 9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma .....                                                                                              | 26 |
| 9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë .....                                                               | 26 |
| 9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë .....                                                               | 26 |
| 9.7. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore .....                                                                   | 26 |
| 9.8. Menaxhimi i mbeturinave .....                                                                                                    | 27 |
| 9.9. Komponentët mjedisor, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve ..... | 28 |
| 10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE .....                                                                                    | 29 |
| 11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....                                                                                                    | 29 |
| 12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME .....                                                                                                 | 30 |
| 12.3. Përfitimet .....                                                                                                                | 30 |
| 13. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE .....                                                                       | 32 |
| 14. LITERATURA E PERDORUR .....                                                                                                       | 33 |

#### **LISTA E FIGURAVE:**

|                                                                       |    |
|-----------------------------------------------------------------------|----|
| Figura 1. Situacioni i Trasesë se Rrugës .....                        | 7  |
| Figura 2 Raporti i rrugës me zonat e veçanta .....                    | 8  |
| Figura 3 Profili tërthor i rrugës me infrastrukture mbështetëse ..... | 11 |
| Figura 4. Rrjeti Hidrografik i zonës ku do të ndërtohet rruga .....   | 16 |

## 1. HYRJE

Ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) është hartuar për projektin e ndërtimit të rrugës “Guri i Matozit – Gradancë” në Mushtisht, Faza I me gjatësi totale prej **2,113.0** metrash. Ky projekt është pjesë e rrjetit themelor rrugor të Komunës së Suharekës dhe ndërlidhet me Parkun Kombëtar “Sharri”, duke e bërë atë një segment të rëndësishëm për zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe rajonale, ky projekt i ndërtimit të kësaj rruge është i parapare në planin hapësinor të Parkut Kombëtarë “SHARRI”.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, duke analizuar faktorët si cilësia e ajrit, biodiversiteti, resurset ujore, përdorimi i tokës dhe ndikimi në komunitetin lokal. Gjithashtu, raporti paraqet masa për të minimizuar ndikimet negative dhe për të siguruar që projekti të zbatohet në përputhje me standardet mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

Ky dokument përbën një hap të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes dhe në garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të infrastrukturës rrugore në këtë zonë me rëndësi ekologjike dhe ekonomike.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM-së) për projektin me interes - Ndërtimi i rrugës Guri i Matozit – Gradancë në Parkun e Sharrit, është strukturuar për të ndjekur një format të vlerësimit të pranuar në përgjithësi dhe reflekton fazat e hartimit të VNM-së komform procedurave dhe ligjeve në fuqi për mjedisin të Republikës së Kosovës, Bashkimit Evropian dhe Konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare. Tereni ku shtrihet rruga është i kodrinor me pjerrësi të theksuara, hapësira-lokaliteti respektivisht zona ku është realizuar projekti i takon Parkut Nacional Sharri, dhe është zonë e mbrojtur e natyrës. Zonat e mbrojtura definojnë si “zona relativisht të mëdha e të administruara nga shteti ose një agjenci shtetërore për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, rekreacion dhe kënaqësi”. Definicioni i IUCN12 për zonat e mbrojtura është se, zonë e mbrojtur është: një zonë e tokës/ujit posaçërisht e dedikuar mbrojtjes dhe përkujdesjes së diversitetit biologjik dhe resurseve natyrore dhe kulturore, si dhe menaxhimi përmes ligjeve dhe metodave tjera efektive. Janë 6 kategori kryesore sipas IUCN-it. Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit që është realizuar, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis, janë komponentët kryesorë të këtij raporti.

## 2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VLERSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Bazuar në karakteristikat e Rrugës “Guri i Matozit – Gradancë” në Mushtisht, Faza I me gjatësi totale prej **2,113.0** metrash me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas gjendjes ekzistuese (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), dhe pasi që ky projekt ndodhet në zonën e mbrojtur të parkut kombëtar Sharri është kërkuar nga Inspektorati i MMPHI-së që të hartohet Elaborati i vlerësimit të ndikimit në mjedis, Ligjit me nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është bazë kryesore ligjore ku jemi referuar.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

-  Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
-  Ligji për VNM Nr.08/L-181
-  Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina,
-  Ligjin nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina
-  Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
-  Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
-  Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
-  Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
-  Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
-  Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110

Pasi që për këtë veprimtari është kërkuar që të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikoj për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

**Bazuar në Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, në Neni 11 Parku kombëtar paragrafët me poshtë;**

*1. Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës.*

### 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TE NDERTIMIT TE RRUGËS “GURI I MATOZIT – GRADANCË” FAZA 1

#### 3.1 Përshkrimi i Lokacionit

Ndërtimi i rrugës automobilistike qe lidhe lokacionin Gradanc në veri të Parkut Nacional Sharri (komuna e Suharekës) deri te Guri i Matozit me rrugën regjionalë R118, e ku do te jete ndërtim ne funksion të pushimit, rekreimit dhe rehabilitimin shëndetësor . Kjo rrugë do ndërtohet neper këto parcela: 03768-0 dhe 03769-0 të cilat janë rruge ekzistuese, këto parcela janë ne zonën kadastrale qe i përkasin Maleve te Sharrit. 1.5 km e para te kësaj rruge qe do te ndërtohet janë përgjatë lumit Mushtisht i cili është degë e lumit Grejkoc.




Figura 1. Situacioni i Trasesë se Rrugës

Përgjatë trasesë se rrugës qe do te ndërtohet , nuk ka shtëpi banimi apo ndonjë veprimtari biznesi, ndërsa zona te mbrojtura , komplet trasa e rrugës është e shtire ne zone te mbrojtur qe është Parku Nacional Sharri, po ashtu afër rrugës ku do ndërtohet kemi zona te veçanta , si Lëndina e Shenjte mbi 300 m dhe ne distance mbi 1.3 km është Rezervuari Rusenica.




Figura 2 Raporti i rrugës me zonat e veçanta

### **3.1 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit**

Projekti i rrugës “Guri i Matozit – Gradancë” në Mushtisht ka një gjatësi totale prej **2,113.0 metrash** dhe është projektuar për të siguruar një lidhje të rëndësishme brenda rrjetit rrugor të **Komunës së Suharekës** dhe **Parkut Kombëtar Sharri**. Rruga do të përmirësojë qasjen e banorëve dhe do të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe turistik të zonës.

#### **1. Gjendja ekzistuese**

Aktualisht, traseja e planifikuar për rrugën përfshin një terren kryesisht malor, ku trasa është **rrugë fshati me sipërfaqe të pa asfaltuar dhe shtigje të ngushta** të cilat janë të vështira për qarkullim, sidomos në kushte atmosferike të pafavorshme. Në te gjithë pjesën e trasesë, rruga ndjek gjurmët ekzistuese, ndërsa në disa pjesë të tjera kërkohet zgjerimi i trasesë.

#### **2. Karakteristikat teknike të rrugës**

- Gjatësia e përgjithshme: 2,113.0 metra

- Gjerësia e rrugës: 5.0 metra
- Bankinat  $2 \times 0.3 = 0.6$  m, me materiali Tampon – fraksion 0-31.5mm.
- Shtresa rrugore: Materiali mbushës - fraksion 0-150mm CBR>15% me trashësi te shtreses  $d=0.3$  cm duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 60 \text{ Mn/m}^2$ ). Tamponit - fraksion 0-63mm me trashësi te shtresës  $d=25$ cm (ne gjendje te ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 80 \text{ Mn/m}^2$ ). Tamponit - fraksion 0-31,5mm me trashësi te shtresës  $d=10$ cm (ne gjendje te ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 80 \text{ Mn/m}^2$ ).
- Shtresa e asfaltit: Dy shtresa asfalti me trashësi totale prej 12 cm. Asfalt betoni nga materiali i njëtrajtshëm AB 16 me trashësi  $t=4,0$ cm në shiritin e qarkullimit të automjeteve me dimensione sipas projektit duke përfshirë lyerjen me emulsion  $0,50 \text{ kg/m}^2$ , dhe bitozhavorrit nga materiali i njëtrajtshëm BZH 22 me trashësi  $t=8,0$ cm në shiritin e qarkullimit të automjeteve me dimensione sipas projektit duke përfshirë lyerjen me emulsion  $0,50 \text{ kg/m}^2$ .

Pjerrësia maksimale: Përputhet me standardet teknike për rrugë malore, duke siguruar qasje të sigurt dhe efikase për automjetet, pjerrësia gjatësore maksimale 14.53 %, ndërsa pjerrësia tërthore maksimale 5.0 %.

Rrezet e kthesave: Projektuar për të garantuar qarkullim të lehtë dhe të sigurt për të gjitha kategoritë e automjeteve. Rrezja minimale është 9.5 ndërsa maksimale 1000.

### 3. Struktura ndihmëse dhe masat mbrojtëse

- **Kanalizimi i ujërave atmosferikë:** Sistemi i drenazhimit për menaxhimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen e rrugës nga erozioni, rigolle me gjersi 0.5cm dhe trashësi 0.15cm.
- **Muret mbajtëse:** Në zona të pjerrëta për të parandaluar rrëshqitjet e dheut.

### 3.2 Përshkrimi i Veçorive Krvesore të Fazës Operative

Pas përfundimit të ndërtimit, rruga “Guri i Matozit – Gradancë” do të hyjë në fazën operative, e cila përfshin përdorimin, mirëmbajtjen dhe ndikimin e saj në qarkullim, mjedis dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

**Funksionaliteti dhe Përdorimi** - Rruga do të shërbejë si një arterie e rëndësishme për lëvizjen e banorëve lokalë, turistëve dhe mjeteve transportuese në rajon. Do të zvogëlojë kohën e

udhëtimit dhe do të përmirësojë aksesin në zonat malore dhe fshatrat përreth. Projektuar për të përballuar një volum të moderuar të trafikut, duke përfshirë automjetet e lehta, mjetet bujqësore dhe ato të transportit të mallrave.

**Mirëmbajtja dhe Siguria Rrugore** - Periodikisht do të kryhet mirëmbajtja e shtresës asfaltike për të parandaluar dëmtimet. Pastrimi i kanaleve dhe sistemit të kullimit për të shmangur përmytjet dhe erozionin. Do të vendosen tabela orientuese dhe sinjalizime të nevojshme për sigurinë e qarkullimit. Monitorim për të parandaluar rrëshqitjet e dheut dhe dëmtimet strukturore.

**Ndikimi në Ekonomi dhe Zhvillimin e Zonës** - Për të minimizuar ndikimin, do të inkurajohet përdorimi i automjeteve me efikasitet të lartë dhe respektimi i shpejtësisë së lejuar. Monitorimi i zonave të ndjeshme ekologjike dhe ndërtimi i vendkalimeve për kafshët nëse është e nevojshme. Do të vendosen kosha për mbeturina në pika strategjike për të ruajtur pastërtinë e zonës. Në përfundim, faza operative e rrugës do të ketë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe zhvillimin ekonomik, duke u siguruar që ndikimet mjedisore të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.

### **3.3 Përshkrimi i procesit të punës**

Ndërtimi i rrugës “**Guri i Matozit – Gradancë**” do të kalojë në disa faza kryesore, duke përfshirë përgatitjen e terrenit, ndërtimin e shtresave rrugore dhe vendosjen e infrastrukturës mbështetëse. Procesi do të realizohet sipas standardeve teknike dhe mjedisore për të siguruar një ndërtim cilësor dhe të qëndrueshëm.

#### **1. Faza e përgatitjes së terrenit**

Kjo fazë përfshin punët përgatitore për të krijuar kushte të përshtatshme për ndërtimin e rrugës.

- Shënimi i traseve: Kryhet matja dhe vendosja e pikave referente për ndërtimin e rrugës.
- Pastrimi i terrenit: Largimi i bimësisë, gurëve dhe objekteve që mund të pengojnë ndërtimin.
- Gërmimi dhe formësimi i terrenit: Përdorimi i mjeteve të rënda për të krijuar profilin e rrugës sipas projektit

#### **2. Ndërtimi i shtresave rrugore**

Pas përgatitjes së terrenit, fillon ndërtimi i shtresave rrugore që sigurojnë qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e rrugës.

- Vendosja e materiali mbushës - fraksion 0-150mm CBR>15% me trashësi të shtresës  $d = 0.3$  cm duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 60 M_n/m^2$ ).

- Vendosja e tamponit - fraksion 0-63mm me trashësi te shtresës d=25cm (ne gjendje te ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 80 \text{ Mn/m}^2$ ).
- Vendosja e tamponit - fraksion 0-31,5mm me trashësi te shtresës d=10cm (ne gjendje te ngjeshur), duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ( $M_t \geq 80 \text{ Mn/m}^2$ ).
- Vendosja e shtresa e Asfaltbetoni nga materiali i njëtrajtshëm AB 16 me trashësi t=4,0cm në shiritin e qarkullimit të automjeteve me dimensione sipas projektit duke përfshirë lyerjen me emulsion 0,50kg/m<sup>2</sup>, dhe
- Vendosja e bitozhavorrit nga materiali i njëtrajtshëm BZH 22 me trashësi t=8,0cm në shiritin e qarkullimit të automjeteve me dimensione sipas projektit duke përfshirë lyerjen me emulsion 0,50kg/m<sup>2</sup>.

### 3. Infrastruktura mbështetëse dhe siguria rrugore

- Ndërtimi i kanaleve anësore dhe vendosja e tubacioneve për të shmangur përmytjet dhe dëmtimin e rrugës.
- Në zona të pjerrëta, vendosen mure betoni ose gurësh për të parandaluar rrëshqitjet e dheut.
- Vendosja e tabelave të qarkullimit, shenjave horizontale dhe vertikale për të rritur sigurinë e përdoruesve të rrugës.
- Ndërtimi i zonave të përshtatshme për lëvizjen e sigurt të banorëve dhe kafshëve.




Figura 3 Profili tërthor i rrugës me infrastrukture mbështetëse

#### 4. Testimi dhe Finalizimi

- Para se rruga të vihet në funksion, kryhen disa kontrole teknike për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e saj: Kontrolli i sipërfaqes së rrugës për të verifikuar qëndrueshmërinë dhe uniformitetin e asfaltit. Testimi i sistemit të drenazhimit për të vlerësuar funksionalitetin e tij në largimin e ujërave. Inspektimi i sinjalistikës rrugore për të garantuar se është e vendosur sipas standardeve. Pranim teknik dhe dorëzimi i projektit për përdorim të plotë nga komuniteti.

#### 5. Menaxhimi i mbetjeve dhe rinatyalizimi

Pas përfundimit të ndërtimit, do të kryhen këto veprime për të reduktuar ndikimin në mjedis. Largimi i mbeturinave ndërtimore dhe transportimi i tyre në vendet e përshtatshme. Rikuperimi i sipërfaqeve të prekura përmes mbjelljes së bimësisë së re dhe stabilizimit të dheut. Monitorimi i hershëm i stabilitetit të rrugës për të identifikuar çdo problem potencial.

Ky proces siguron një ndërtim efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrugës **“Guri i Matozit – Gradancë”**, duke garantuar që ajo të përmbushë nevojat infrastrukturore dhe të ndikojë pozitivisht në zhvillimin lokal.

#### **3.5 Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit**

Gjatë fazës operative të rrugës **“Guri i Matozit – Gradancë”**, do të prodhohen mbetje dhe emetime të ndryshme që lidhen kryesisht me trafikun, mirëmbajtjen dhe përdorimin e rrugës nga automjetet dhe komuniteti lokal. Këto mbetje dhe ndotës ndahen në mbetje të ngurta, mbetje të lëngëta dhe emetime ajrore, të cilat kërkojnë masa të veçanta menaxhimi për të reduktuar ndikimin e tyre në mjedis.

**Ajer:** Trafiku i automjeteve do të gjenerojë emetime të gazrave të dëmshëm, kryesisht dioksid karboni (CO<sub>2</sub>), monoksid karboni (CO), okside të azotit (NO<sub>x</sub>) dhe grimca PM10 dhe PM2.5. Bazuar në intensitetin e trafikut dhe kategorinë e mjeteve, vlerësohet se gjatë një viti mund të lëshohen në atmosferë:

- 300-500 ton CO<sub>2</sub>, si rezultat i djegies së karburanteve.
- 20-40 ton NO<sub>x</sub>, që kontribuojnë në formimin e smogut dhe ndotjen e ajrit.
- 5-10 ton grimca të imëta PM10 dhe PM2.5, të cilat ndikojnë në cilësinë e ajrit

**Ujë :** Gjatë operimit të rrugës, një ndër burimet kryesore të ndotjes së ujit janë vajrat dhe derivatet e naftës që mund të rrjedhin nga automjetet. Pritet që këto rrjedhje të jenë në intervalin **500-1000 litra në vit**, sidomos në pikat ku trafiku është më i dendur ose në rastet e aksidenteve.

Për minimizimin e ndikimit të tyre, do të ndërtohen kanale kullimi dhe sisteme filtrimi për të parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

**Dhe:** Gjatë fazës operative të rrugës **“Guri i Matozit – Gradancë”**, ndotja e tokës ndodhë për shkak të mbetjeve të ngurta, rrjedhjeve të lëngëta nga automjetet dhe materialeve të shpërndara nga trafiku i rënduar. Kjo ndotje mund të ndikojë cilësinë e tokës, biodiversitetin dhe burimet ujore nëntokësore, prandaj është e rëndësishme të vlerësohet dhe menaxhohet me kujdes.

**Flora dhe Fauna:** Rruga "Guri i Matozit – Gradancë" kalon në një zonë me rëndësi ekologjike, pasi ndodhet brenda Parkut Kombëtar të Sharrit. Kjo zonë karakterizohet nga një biodiversitet i pasur me lloje të ndryshme bimësh dhe kafshësh, të cilat mund të ndikohen nga ndërtimi dhe operimi i rrugës. Në këtë seksion do të përshkruhen llojet kryesore të florës dhe faunës, si dhe ndikimi i mundshëm i projektit në to. Megjithatë, me masa të përshtatshme mbrojtjeje dhe monitorimi të vazhdueshëm, ndikimet negative mund të minimizohen, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës dhe mbrojtjen e natyrës.

**Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Ndërtimi dhe operimi i rrugës **"Guri i Matozit – Gradancë"** do të ketë ndikime të rëndësishme sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal. Përmirësimi i lidhjeve tregtare, rritja e investimeve dhe punësimi janë disa nga përfitimet kryesore, ndërsa zhvendosja e komuniteteve, ndotja dhe rreziqet për habitatet natyrore janë sfidat kryesore. Për të siguruar që ky projekt të ketë një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm, nevojiten masa të kujdesshme menaxhuese dhe bashkëpunim i ngushtë me komunitetin dhe autoritetet lokale.

#### 4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR NDËRTIMIN E RRUGËS KRYESORE “GURI I MATOZIT – GRADANCË”

Ndërtimi i rrugës "Guri i Matozit - Gradancë" në Mushtisht është rezultat i një analize të kujdesshme të nevojave infrastrukturore dhe karakteristikave të zonës. Alternativat e arsyeshme për ndërtimin e kësaj rruge janë shqyrtuar duke marrë parasysh disa faktorë kyç, si terreni, funksioni rekreativ i zonës dhe lartësia mbidetare e favorshme.

- Terreni i zonës luan një rol të rëndësishëm në nevojën për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Rruga e propozuar do të lehtësojë qarkullimin dhe do të mundësojë një lidhje më të sigurt dhe efikase midis lokaliteteve. Në mungesë të kësaj rruge, lëvizshmëria e banorëve dhe transporti i mallrave do të mbeten të kufizuara, duke ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës.
- Zona ka një potencial të lartë për aktivitete rekreative dhe turizëm. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të krijojë qasje më të lehtë për vizitorët dhe do të nxisë zhvillimin e aktiviteteve natyrore si ecja malore, eksplorimi dhe turizmi rural. Kjo do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke sjellë përfitime për komunitetin lokal dhe bizneset që operojnë në sektorin e turizmit dhe rekreacionit.
- Lartësia mbidetare e zonës është e përshtatshme dhe ndërtimi i rrugës është i justifikueshëm nga pikëpamja inxhinierike dhe mjedisore. Lartësia mbidetare favorizon kushte klimatike të qëndrueshme dhe ofron mundësi për zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës pa rrezik të lartë nga faktorë natyrorë, si erozioni apo përmbytjet.
- Rruga ekzistuese mund të jetë e dëmtuar ose jo e përshtatshme për lëvizje të sigurt, veçanërisht në kushte të pafavorshme atmosferike. Ndërtimi i rrugës së re me standarde më të mira do të zvogëlojë rrezikun e aksidenteve dhe do të përmirësojë kushtet e transportit për banorët dhe vizitorët.

Duke marrë parasysh këta faktorë, ndërtimi i rrugës "Guri i Matozit - Gradancë" paraqitet si një alternativë e arsyeshme dhe e nevojshme për të përmirësuar qasjen, për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të krijuar një infrastrukturë të qëndrueshme që i shërben komunitetit dhe mjedisit përreth.

## 5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Mjediti në Parkun Kombëtar “Sharri” është një nga më të pasurit dhe më të rëndësishmit në Kosovë, duke ofruar një biodiversitet të jashtëzakonshëm, peizazhe të mrekullueshme dhe ekosisteme të ruajtura natyralisht. Ky park shquhet për relievin e tij malor, me majat e larta të Sharrit, lugina të thella dhe pllaja alpine që krijojnë një peizazh të larmishëm dhe unik. Parku Kombëtar “Sharri” është një pasuri natyrore e jashtëzakonshme, ai përballlet me sfida mjedisore si shpyllëzimi i paligjshëm, ndotja dhe ndërhyrjet njerëzore. Për të mbrojtur këtë ekosistem të çmuar, janë marrë masa për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, duke promovuar praktika që nuk dëmtojnë mjedisin.

### 5.1. Hidrografia

PN ‘Mali Sharr’ e karakterizojnë sasitë e mëdha të reshjeve atmosferike të cilat i japin atrakcion këtij territori. Karakteristikë e përgjithshme është se rrjedhjet e ujërave sipërfaqësore, nga burimi deri në grykëderdhje, janë shumë të shpeshta. Pos rrjedhjeve të shpeshta dhe të pasura, me ujë të përrunjve dhe lumenjve malorë, me numër të shprehur të ujëvarave dhe rrjedhjeve të rrëkeve, këtë territor e presin në të gjitha drejtimet. Rajoni i Malit Sharr është i pasur edhe me disa liqeje akullnajorë (glacial). Pothuajse i tërë territori i parkut nacional i takon dy pellgjeve të lumenjve më të mëdhenj – Lepencit dhe Lumbardhit të Prizrenit. Për nga atraksioni i vet dallohet Lepenci përkatësisht degët e djathta të tij të cilat njëkohësisht kalojnë edhe nëpër pjesët më të bukura dhe shtigjet kryesore të skijimit të Malit Sharr. Lepenci buron dhe krijohet me bashkimin e rrjedhjeve të cilat burojnë nga malet e Cerevës dhe Jezercit. Në rrjedhjen e vetë nëpër territorin e Parkut Nacional atij i bashkëngjiten disa degë nga ana e majtë dhe e djathtë. Posaçërisht janë të rëndësishme degët e djathta të përrunjëve dhe lumenjëve siç janë lumi i Thatë, Murzhica me degët e veta tejet atraktive Proska e Dulës, Bllateshtica, lumi i Bollonjskës dhe Kallugjerica. Këta lumenj, degët burimore të të cilëve vijnë nga malet më të larta në pjesët më jugore të parkut nacional, janë të shpejta me një numër të ujëvarave dhe rrjedhjeve të rrëkeve. Derisa rrjedhja e Lepencit zë pjesën më të madhe verilindore të Parkut Nacional, derdhja e Lumbardhit të Prizrenit mbulon pjesët jugperëndimore të tij. Pjesën më të madhe të këtij pellgu lumor, janë degët e majta, të cilat burojnë nga malet e larta të Majës së Zezë, Koblicës, Kara Nikollës etj, dhe si të tilla rrjedhjet e sipërme të tyre janë shumë të shpejta dhe atraktive. Posaçërisht dallohet dega e proskës së Lubinit me degët e veta. Liqenet glaciale paraqesin njërën nga bukuritë më të mëdha të Malit Sharr. Në lartësinë mbidetare mbi 1,900 m ka disa liqeje të cilët posaçërisht dallohen sipas bukurisë dhe madhësisë. Këtu vlen të përmenden para së gjithash Liqeni i Livadicës dhe Liqeni i Jazhincës e pastaj edhe të tjerë si:

Liqenet e Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës, Bezdankës etj. Liqeni më i madh është ai i Livadicës, i cili shtrihet nën majën malore me po të njëjtin emër në l.m. prej 2,173 m. Ka formë të zgjatur, me gjatësi prej 230 m, gjerësi 120 m, dhe thellësinë më të madhe prej 7.3 m. Në kohën e verës temperatura e ujit ndonjëherë arrinë edhe deri në 20°C. Liqeni i Jazhincës shtrihet në pjesën shkëmbore të Sharrit – nën majën e Bistrës. Është më i vogël se Liqeni i Livadicës, ka gjatësinë prej rreth 120m, gjerësinë 80m dhe thellësi deri në 11m. Liqenet e Gornjësellës (i Epërm dhe i Poshtëm), shtrihen mbi burimin e Bistricës së Prizrenit dhe është i madh – gjatësia 100 m, gjerësia 53 m ndërsa thellësia 1.5 m. Ngjyra e ujit liqenor shkon prej të kaltrës deri në të gjelbërt..




Figura 4. Rrjeti Hidrografik i zonës ku do të ndërtohet rruga

## **5.2. Kushtet klimatike**

Parku Nacional "Mali Sharr" sipas klasifikimit klimatik të Kosovës hynë në klimën lindore kontinentale. Kurse, në vet Parkun Nacional dominojnë klimat alpke dhe ajo kontinentale, e cila herëpashere ndikohet nga klima e mesme kontinentale. Faktorët kryesor që ndikojnë në klimën e një rajoni janë elementet dhe dukuritë meteorologjike. Në hapësirën e Parkut Nacional, është vetëm një vend-matje (apo stacion meteorologjik) në Brezovicë, me lartësi mbidetare 860 m, i cili daton që nga viti 1949. Ndërsa, stacioni tjetër më i afërt, është ai i Jazhincës me lartësi mbidetare të vend-matjes 950 m dhe gjendet në Republikën e Maqedonisë, i cili ka raportuar të dhëna meteorologjike gjatë viteve 1949 - 1991. Nga analiza e bazës së të dhënave në sektorin e meteorologjisë në IHMK, për këto dy stacione (vend-matje) rezulton që temperatura mesatare vjetore shumë vjeçare është 8.4 gradë celsius. Muaji me i ftohtë është

Janari me -1.8 dhe -1.3 gradë celsius, kurse vlerat ekstreme të temperaturës në të dy vend-matjet janë ato të vitit 1963 me -33 dhe -34 °C dhe se temperatura mesatare ditore luhet nga 18 – 20°C. Vlera mesatare e lagështisë relative është 67-70 % për dy vend-matjet. Erërat arrijnë shpejtësinë nga 1-16 m/s, dominojnë drejtimet e erës nga ana e Jugut, jugperëndimit dhe juglindjes. Sasia e reshjeve si vlerë mesatare në Shtërpçë dhe Jazhincë variojnë nga 670 deri në 1200 mm. Në muajin shkurt dhe mars shpesh herë shkaktohen edhe ortehtët e borës ku si pasojë kanë humbur jetën edhe disa qytetar. Ditë me diell në këtë rajon janë 220 deri në 280. Vranësirat dhe lidhshmëria me rrezatimin e diellit dukshëm mund të ndikojnë në valorizimin turistik të ndonjë territori e sidomos malor. Mirëpo, për shkak të paraqitjes së inverzionit të temperaturës si dhe paraqitjet e shpeshta të mjegullës në luginat rreth e rrotull, rrezatimi diellor në Malin Sharr zgjat me tepër gjatë dimrit, sidomos në pjesët e ekspozuara kah diell.

### **5.3.Zonat e Mbrojtura**

Në lokacionin ku do të ndërtohet impianti, nuk ka zona të mbrojtura mjedisore. Ky informacion është i rëndësishëm për vlerësimin e mundësive të zhvillimit të impiantit, pasi mungesa e zonave të mbrojtura lehtëson ndërtimin dhe operimin e projektit pa u penguar nga kufizime ligjore apo mjedisore që mund të aplikohen në zona të mbrojtura.

### **5.4. Flora, fauna dhe persazhi**

Për nga aspekti floristik, PN “Mali Sharr” bën pjesë në malet më të begatshme të Gadishullit Ballkanik. Këtu vërehet prezenca e një numri të llojeve drunore endemike dhe relikte, siç janë arneni i bardh, rrobulli, panja malore, bresheu i rëndomt, kërleka, lloj i rëndësishëm për pyllëzimin e sipërfaqeve të erodura si dhe Rododendra ferrigineum . Në rajonin e lartë malor, duhet të përmenden llojet e rëndësishme të maleve të larta, areali i të cilave është i lidhur, kryesisht për malet e larta të Europës jugore dhe të mesme (Alpe, Apenine, Karpate, Pirinej, Tatra). Kështu prej këtyre llojeve do të ceken: Troli europian, Zhabinorja malore, Zhabinorja ura-ura, Zhabinorja maledashëse, Karafili pyjor, Xërxelja alpine, Shelgu i fletëtopitur, Shelgu i rrjetëzuar, Empetri, Mlaka malore, Iriqëza gjethekundrejtë, Iriqëza arëtoje, Iriqëza si thonjë, Genciana pranverore, Genciana, Kulmaku i çarë tresh, Elyna myosuroides, Presja, Presja e zezë, Flokëza e vogël, Tërshëra) dhe shumë lloje tjera. Llojet bimore mjekësore janë: barpezmi mijëfletësh, rrush arushe, helmarina, lulebalsami, zhumbrica, shtara e bardhë, lloji i sarëzës etj. Përkundrejt llojeve bimore që janë banorë të viseve të larta, ku bimët zhvillohen thuaja se në borë, në pjesët e ulta, si pasojë e veprimt të Mesdheut, përgjatë Lumbardhit të Prizrenit, respekti vishte Grykës së Kaçanikut, në po këtë mal jetojnë edhe lloje të tjera siç janë: Salvia officinalis, Ruta, Arrësi barëmajasëlli, Ferrëmi, Këleria e shëndritshme, Pendëkaposhi

mesdhetar, Parenticella gjethegjërë, Linaria e peliserit, Armiza e stërhapur, Derdhja, Kokoçelli, e tjera. E gjithë kjo që është cekur me specifitetet dhe begatinë e florës së PN “Malit Shar”, flet për rëndësinë e jashtëzakonshme të tij në aspektin floristik.

**Fauna** - Territori i Sharrit me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezentë lloje të veçanta të shtazëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike, që d.m.th. se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Ndërsa llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi fauna e Kosovës deri sot nuk është hulumtuar sa duhet., deri më tani janë evidentuar: 7 lloje peshqish, 9 lloje amphibie, 10 lloje reptil, 154 lloje shpend dhe 30 lloje gjitarësh.

### **5.5.Ndotja dhe degradimi**

